

1 QERSHOR ME FËMIJËT E FAMILJES SË MADHE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Në Ditën Botërore të Fëmijëve së bashku me Ministren Ogerta Manastirliu festuam me vogëlushët e Hana dhe Rozafës. Nën shoqërinë e maskotave të Hamleys kënduam dhe shpërndamë dhurata për të gjithë fëmijët.

Gëzuar 1 Qershorin fëmijë! Festofshi çdo ditë si të ishte 1 Qershor!

#AKSES PËR TË GJITHË



Në Muzeun Historik “Oso Kuka” të Shkodrës në bashkëpunim me Organizatën “The Door”, mbështetësin e përhershëm të shërbimit social dhe të gjithë personave me aftësi të kufizuar të Shkodrës, mundësuam dhurimin e rampës ku këta persona do ta kenë më të lehtë ta vizitojnë muzeun sa herë të dëshirojnë.

Me një grup përfaqësuesish të personave me aftësi të kufizuar u realizua vizita e parë në ambientet e muzeut e cila u drejtua me shumë përkushtim drejtoresha e muzeut znj. Amila Gjyrezi.



SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Qershor 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar dy raste emergjente. Janë mbledhur komisionet për sistemimin në institucione, nga të cilat janë sistemuar dy raste PAK, 7 sistemime të moshuarish dhe 1 transferim. Është mbledhur komisioni për statusin e jetimit nga i cili kanë përfituar status 33 raste.

Janë kryer monitorime në IPSH publike “Shtëpia e Fëmijës Sarandë” dhe “ Qendra Polivalente Sarandë”.



#SHTËPIA E FËMIJËS ZYBER HALLULLI



Shkolla mbaroi, tani le të shijojmë diellin! Pushime verore sapo kanë nisur. Fëmijët e familjes sonë të Zyber Hallullit prej datës 19 Qershor po ndjekin aktivitetet e kampit veror të mundësuar nga miqtë tanë besnikë të “Shpresë për Botën”. Në shoqërinë e shokëve dhe shoqeve po kalojnë ditë të mbushura me të qeshura dhe lojra të shumëllojshme.

Mirënjohje për miqtë tanë të “Shpresë për Botën” që si gjithmonë zgjedhin aktivitetet më të bukura për të argëtuar fëmijët.